



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 29.4.2021

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 29.4.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Artan Madani, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara nga Kolegji, në cilësinë e provës gjatë hetimit gjyqësor, Komisioneri Publik, në përfundim, duke iu përmbajtur parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim në seancat e datave 18 mars, 22 dhe 29 prill 2021, konstaton se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

Për Komisionerin Publik, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje nga ana juaj, hetimit gjyqësor të kryer, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, mbeti e provuar se:

*1. Për shkakun ankimor, për pasurinë “Apartament banimi 146 m²” dhe pasurinë “Garazh 10 m²”, në rrugën “***” Durrës*

1.1 Përfundimet në ankim për këtë shkak, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, janë se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa i përket: (i) gjendjes juridike të pasurisë: “*Apartament me sipërfaqe 146 m²*” në momentin e krijimit; (ii) pronësisë mbi garazhin, në deklaratën e parë të deklarimit të pasurisë; (iii) burimeve të ligjshme të financimit për këto pasuri, si ato të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, ashtu dhe ato të deklaruara për herë të parë gjatë hetimit administrativ; (iv) mundësisë financiare të dhuruesve, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur.

1.2 Komisioneri Publik, ashtu sikurse është argumentuar në pikën 5.4 të Rekomandimit të ONM-së, konstaton se, edhe duke konsideruar në mesin e burimeve të ligjshme dhurimet e z. *** ***, në shumën 300.000 lekë, për vitin 2002-2003, në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit dhe ato të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, për pasurinë “*Apartament 146.43 m²*” dhe pasurinë “*Garazh 10 m²*”, konstatohet se, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, rezulton se deklarimi gjendet i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga subjekti i rivlerësimit.

2. *Për shkakun e ankimit, mungesa e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme, për investimin në “Fondin e *** ***”, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank, gjendjes cash në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë dhe rezultatet e analizës dhe treguesve financiarë ndër vite*

2.1 Përfundimet në ankim për këtë shkak, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, janë se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi investimin në “Fondin e *** ***” dhe për krijimin e gjendjes *cash* në banesë mbeten të pamjaftueshme.

2.2 Në këto kushte, ashtu sikurse është argumentuar në pikën 5.4 të Rekomandimit të ONM-së, në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit dhe ato të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, konstatohet se, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, rezulton se deklarimi gjendet i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për investimin në “Fondin e *** ***”, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank, dhe gjendjes *cash* në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë.

3. *Për shkakun ankimor për automjetin me targë AA****

3.1 Vlerësohet se aktet e paraqitura, situatën e provueshmërisë e lënë të njëjtë. Subjekti i rivlerësimit, deklaratimet e tij, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, i mbështeti në aktin noterial datë ***.1.2017, të administruar në këtë gjykim, mbi ndërprerjen e marrëdhënies juridike për përdorimin e mjetit, dy ditë para dorëzimit të Deklaratës “Vetting”.

Kërkimi përfundimtar i ankimit

4. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik, *për kriterin e pasurisë*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, në përfundim të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, si dhe të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, gjatë këtij hetimi gjyqësor, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4.1 Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani, prokuror/Drejtuës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kavajë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA